

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M   Q A R K U L L U E S

Nr. 24, datë 30.07.2020


**Mbi dhënien e autorizimit paraprak Drejtorit të Përgjithshëm, për fillimin e negociatave dhe hartimin e projekt marrëveshjes së linjës së kredisë në gatishmëri, ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Agjencisë, në rast të një ngjarjeje sigurimi**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “n”, neni 52, pika 1, shkronja “nj” dhe pika 2, të nenit 53, pika 6, shkronja “b”, të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, të nenit 60 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6, të nenit 8, pika 2, shkronja “b” dhe shkronja “r”, pika “i” dhe pika “iv” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 5, pika 2, shkronja “b” të rregullores të Këshillit Drejtues nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të nenit 18, pika 2 të rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

---

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e autorizimit paraprak Drejtorit të Përgjithshëm, për fillimin e negociatave dhe hartimin e projekt marrëveshjes së linjës së kredisë në gatishmëri, ndërmjet Agjencisë së



## KËSHILLI DREJTUES

Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Agjencisë, në rast të një ngjarjeje sigurimi.

2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm dhe njësitë organizative të Agjencisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**